



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 482 Prot.

Tiranë, më 20 .03 .2024

**V E N D I M**

**Nr. 76, Datë 20. 03. 2024**

Bazuar në ligjin Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O N :**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar ankesën nr. 37 Regj., datë 07.03.2023, të paraqitur nga znj. H. Ç, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit të udhëtarëve Durrës – Berat. Me vendimin nr.175, datë 11.09.2023, Komisioneri ka disponuar në lidhje me çështjen, duke vendosur:

1. *Konstatimin e diskriminimit të ankueses H.Ç, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë LEDJAN shpk.*
2. *Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, Shoqëria LEDJAN sh.p.k shpk të marrë masa të menjëhershme për mospërsëritjen në të ardhmen të situatave të ngjashme dhe për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie. Me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, Shoqëria LEDJAN sh.p.k duhet të marrë masat e mëposhtme:*
  - *Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

- Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
  - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë Vendim, Shoqëria LEDJAN shpk, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
  5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar se, Shoqëria LEDJAN sh.p.k ka marrë dijani për vendimin në datën 12.09.2023.

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se : “11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.”

Në kundërshtim me nenin 33, pika 11, të LMD, Shoqëria LEDJAN sh.p.k nuk raportoi para Komisionerit brenda afatit ligjor 30 ditor, në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

Me shkresën nr.231 prot, datë 05.02.2024, Komisioneri kërkoi nga Shoqëria LEDJAN sh.p.k informacion mbi plotësimin e masave të dhëna me vendimin nr.175, datë 11.09.2023. Shoqëria LEDJAN sh.p.k nuk ktheu asnjë përgjigje edhe pse rezulton sipas lajmërim marrjes së shërbimit postar se ka marrë dijani për këtë shkresë në datën 08.02.2024.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, Shoqëria LEDJAN sh.p.k, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka marrë masa për zbatimin e vendimit nr.175, datë 11.09.2023, të Komisionerit. Në këtë mënyrë, Shoqëria LEDJAN sh.p.k, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të

nenit 33, pika 13, të ligjit të sipërpërmendur, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Shoqëria LEDJAN sh.p.k, ky nen përcakton shkrehimisht: “Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:..... b) *personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....*”

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Shoqëria LEDJAN sh.p.k është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33, pika 13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku sanksionohet se: “12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe bazuar në faktin që, shkelja e konstatuar prek personat me aftësi të kufizuar, të cilët janë një kategori që gëzon një mbrojtje të veçantë dhe një grup vulnerabël; faktin që, Shoqëria LEDJAN sh.p.k është përsëritëse në konsumimin e shkeljeve të së njëjtë natyrë<sup>2</sup>; Komisioneri, arrin në përfundimin se, Shoqëria LEDJAN sh.p.k, duhet të gjobitet me 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr.175, datë 11.09.2023.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ç”, nenin 33, pika 11, 12 dhe 13, germa “b”, si dhe nenin 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Shoqëria LEDJAN sh.p.k, të gjobitet në vlerën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr.175, datë 11.09.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

---

<sup>2</sup> Vendimi i Komisionerit nr.137, datë 26.07.2023 dhe vendimi me gjobë për moszbatim vendimi nr. 74, datë 20.03.2024.

2. Gjoba të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 ( dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.
3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit nr.175, datë 11.09.023, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**